

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për Rezervat Materiale të Shtetit”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Mbrojtjes
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Burim i brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Jo e zbatueshme
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	09.05.2019
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	13.05.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po, 15.05.2019
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019 – MM – Nr.2
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Leonard Kolgjini: leonard.kolgjini@mod.gov.al 0686065598
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i> Sipas legjislacionit aktual në fuqi, ligji nr.9900, datë 10.04.2008, “Për Rezervat Materiale të Shtetit”, lëvrimi i mallrave të grupit B dhe C bëhet me anë të një akti individual “Urdhër i ministrit” dhe “Urdhër i Drejtorit të përgjithshëm”. Kjo mënyrë e bën më të lehtë dhe më të shpejtë lëvrimin e mallrave të grupeve përkatëse, sipas kushteve dhe rrethanave të parashikuara ligjërisht. Për shkak se lëvrimi i mallrave të grupit A bëhet nëpërmjet një akti të nxjerrë nga një organ kolegjal, siç është Këshilli i Ministrave, kjo sjell vonesa në miratimin e aktit dhe si pasojë në lëvrimin e tyre. Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme për unifikimin e procedurës së lëvritimit të mallrave rezervë të shtetit, të secilit grup nëpërmjet një akti individual hierarkik, si rrjedhojë lëvrimi i mallrave të grupit A, të bëhet me urdhër të Kryeministrit dhe jo me vendim të Këshillit të Ministrave.	
OBJEKTIVAT <i>Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?</i> - Të unifikohet akti i lëvritimit të mallrave të grupit A me ato të grupeve të tjera duke u bërë me urdhër për të tre kategoritë A, B dhe C. Kjo nisur edhe nga fakti që Këshilli i Ministrave nuk shprehet me urdhra por vetëm me vendime, të cilat kanë një regjim tjetër trajtimi. - Të bëhet i mundur lëvrimi i mallrave të grupit A, në një kohë më të shpejtë.	
OPSIONET E POLITIKAVE <i>Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.</i>	

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikës:
Opsioni 0 (status quo): Procedurat të vijnë me kuadrin ekzistues në fuqi: Ligji nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të Shtetit”.
Opsioni 1: Ndryshimi i Ligjit ekzistues nr. 9900/2008 “Për rezervat materiale të Shtetit”.
Opsioni 2: Të hartohet dhe miratohet një ligj i ri unifikues.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndryshimi i kuadrit ligjor ekzistues nuk ka ndikime në vlera monetare të përcaktuara pasi rregullon vetëm mënyrën e lëvrimit të mallrave të grupit A, të cilat administrohen sipas ligjit “Për rezervat materiale të shtetit”, duke e bërë më fleksibël lëvrimin e tyre nëpërmjet një urdhri të Kryeministrit dhe jo me një Vendim të Këshillit të Ministrave, Ky fleksibilitet sjell efikasitet më të madhe në menaxhimin e këtyre mallrave, uljen e veprimeve administrative (nuk mblidhet më organi kolegjal (Këshilli i Ministrave) për çështjet e lëvrimit të mallrave të grupit A, por ezaurohet me akt individual duke bërë të mundur lëvrimin në kohë më të shpejtë të mallrave edhe në rastet e nevojave urgjente, të cilat lindin për shkak të emergjencave natyrore apo për shkak të emergjencave të krijuara nga veprimtaritë njerëzore.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/preferuar është Opsioni 1. Ky opsion do të sigurojë një lehtësi në administrimin e mallrave të grupit A, të rezervave materiale të Shtetit, duke iu përgjigjur më shpejt kërkesave të subjekteve të tjera shtetërore apo enteve publike të cilat kanë në fushë të përgjegjësisë së tyre shtetërore, menaxhimin e situatave emergjente të cilat shkaktohen nga emergjencat natyrore apo emergjencat civile.

Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Konsultime mbi projektligjin janë realizuar online, nëpërmjet regjistrit elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik gjatë periudhës maj 2019.
 Nga konsultimi publik nuk pati diskutime/reagime, pasi ndryshimet në projektligj nuk prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë grupe interesi apo qytetarë.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Për zbatimin e opsionit të preferuar dhe monitorimin e tij, ngarkohen institucione shtetërore, të cilat administrojnë dhe lëvrojnë rezervat materiale të shtetit si: Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Baza juridike në fuqi për administrimin e rezervave materiale të shtetit është Ligji nr. 9900, datë 10.04.2008, “Për Rezervat Materiale të Shtetit”, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1128, datë 5.8.2008 “Për Krijimin dhe Administrimin e Mallrave Rezervë Materiale Shtetërore”.

Ligji ka për qëllim të vendosë bazat juridike dhe administrative për rregullimin e marrëdhënieve që lindin, ekzistojnë dhe shuhen gjatë administrimit, mirëmbajtjes dhe kontrollit të mallrave në rezervat materiale të shtetit.

Rezervat materiale të shtetit krijohen për të ndërhyrë, në mënyrë operative, për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë dhe mbrojtjen e vendit, në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencës civile, veprimeve terroriste, veprimeve ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin. Rezervat materiale të shtetit përdoren edhe për dhënien e ndihmave humanitare, në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Përshkrimi i natyrës së problemit:

Neni 10 i ligjit nr. 9900/2008 “Për Rezervat Materiale të Shtetit”, përcakton se lëvrimi dhe shitja e mallrave të grupit A, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të Ministrit përgjegjës për rezervat materiale të shtetit. Ndërkohë që lëvrimi i mallrave të grupit B dhe grupit C, bëhen me akte individuale dhe përkatësisht mallrat e grupit B, lëvrohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit (DPRMSH), ndërsa mallrat e grupit C, lëvrohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DPRMSH.

Identifikimi i shkaqeve të problemit

Baza ligjore aktuale (neni 10 i ligjit), për lëvrimin dhe shitjen e mallrave të grupit A, vendos si kusht Vendim të Këshillit të Ministrave

Për të bërë të mundur lëvrimin në një kohë sa më të shpejtë të mallrave rezervë të shtetit është i nevojshëm ndryshimi i nenit 10 të ligjit, duke përcaktuar lëvrimin e tyre me urdhër të Kryeministrit me propozim të Ministrit përgjegjës për rezervat materiale të shtetit.

Përshkrimi i shtrirjes së problemit:

PROBLEMI që kërkon të zgjidhet shtrihet që nga periudha e miratimit të ligjit nr. 9900/2008 “Për Rezervat Materiale të Shtetit”.-

Grupet e prekura nga ky problem:

1. Përdoruesit fundor dhe qytetarët (p.sh. në rastin e emergjencave civile e natyrore për të përfituar në një kohë sa më të shpejtë nga lëvrimi i mallrave të grupit A).
2. Institucionet shtetërore të cilat me ligj janë ngarkuar për menaxhimin apo marrjen pjesë në përballimin e emergjencave natyrore/civile.

Arsyeja e ndërhyrjes

- Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.
- Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.
- Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.
- Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.
- Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.

Pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme:

Aktualisht rregullimet për administrimin e rezervave materiale të shtetit përcaktohen nga Ligji nr. 9900/2008 “Për rezervat materiale të Shtetit”.

Qeveria planifikon të ndërhyjë për të thjeshtuar procedurat e lëvrimin të mallrave rezervë të shtetit të cilat i përkasin grupit A duke qenë se mallrat e këtij grupi mund të shërbejnë në përballimin e situatave të papritura dhe emergjente (rikujtojmë se mjetet e tonazhit të rëndë si ekskavatorë etj, janë pjesë e grupit A).

Çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje:

Thjeshtimin e procedurave për lëvrimin apo shitjen e mallrave të grupit A, të cilat administrohen sipas ligjit nr. 9900/2008 “Për rezervat materiale të Shtetit”.

Puna ekzistuese që është realizuar tashmë:

Nisma është ndërmarre nga vetë Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile duke propozuar draftin fillestar dhe parashtruar arsyet e nevojës së ndryshimit ligjor.

Objektivi i politikës

- Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.
- Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.
- Të unifikohet akti i lëvrimin të mallrave të grupit A me ato të grupeve të tjera duke u bërë me urdhër për të tre kategoritë. Kjo nisur edhe nga fakti që Këshilli i Ministrave nuk shprehet me urdhra por vetëm me vendime, të cilat kanë një regjim tjetër trajtimi.
- Të bëhet i mundur lëvrimi i mallrave të grupit A, në një kohë më të shpejtë.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- Përshkruani opsionin e status quo-së.
- Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.
- Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.

Opsioni 0: Status Quo

Ky opsion nuk sjell asnjë ndryshim, dhe nuk rregullon dhe as përmirëson procedurat që janë aktualisht në legjislacionin shqiptar, për çdo rast kur lind nevoja për lëvrime të mallrave të grupit A, duhet të fillojë procedura për miratimin e një Vendimi të Këshillit të Ministrave.

Opsioni 1: Ndryshimi i ligjit ekzistues.

Ky opsion parashikon thjeshtësimin e procedurave për lëvrimin e mallrave të grupit A, minimizimin e kohës së kërkuar për realizimin e procedurës së lëvrimit të këtyre mallrave. Për rastet ku lind nevoja për lëvrimin e mallrave të grupit A, për shkak të emergjencave apo me kërkesë të institucioneve të tjera shtetërore apo publike, koha për lëvrimin e tyre është më e shpejtë.

Opsioni 2: Të hartohet dhe miratohet një ligj i ri unifikues.

Ky opsion nuk është i aplikueshëm pasi nuk synohet ndryshim, i cili dikton nevojën e një ligji të ri unifikues. Kjo për arsye se nuk nevojitet ndërhyrja në asnjë dispozitë tjetër të ligjit për të arritur qëllimin e synuar.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- Identifikoni se kush preket.
- Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.
- Për ndikimet e drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.
 - Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).
 - Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.
- Diskutoni kufizimin e analizës:
 - Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.
 - Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.
 - Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.
- Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:
 - Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.
 - Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.
 - Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).

Grupet e interesit që preken nga kjo politikë, janë:

- përdoruesit fundor dhe qytetarët (p.sh. në rastin e emergjencave civile e natyrore për të përfituar në një kohë sa më të shpejtë nga lëvrimi i mallrave të grupit A).

- Institucionet shtetërore të cilat me ligj janë ngarkuar për menaxhimin apo marrjen pjesë në përballimin e emergjencave natyrore/civile.

Ndryshimi i kuadrit ligjor ekzistues nuk ka ndikime në vlera monetare të përcaktuara pasi rregullon vetëm mënyrën e lëvrimit të mallrave të grupit A, të cilat administrohen sipas ligjit “Për rezervat materiale të shtetit”, duke e bërë më fleksibël lëvrimin e tyre nëpërmjet një urdhri të Kryeministrit dhe jo me një Vendim të Këshillit të Ministrave, Ky fleksibilitet sjell efikasitet më të madhe në menaxhimin e këtyre mallrave, uljen e veprimeve administrative (nuk mblidhet më organi kolegial Këshilli i Ministrave për çështjet e lëvrimit të mallrave të grupit A, por ezaurohet me akt individual duke bërë të mundur lëvrimin në kohë më të shpejtë të mallrave edhe në rastet e nevojave urgjente të cilat lindin për shkak të emergjencave natyrore apo për shkak të emergjencave të krijuara nga veprimtaritë njerëzore.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni 1, është opsioni i preferuar, i cili është projektligj për ndryshimin e ligjit nr. 9900/2008 “Për Rezervat Materiale të Shtetit”, pasi ky opsion do të sigurojë një lehtësi në administrimin e mallrave të grupit A, të rezervave materiale të Shtetit, duke iu përgjigjur më shpejt kërkesave të subjekteve të tjera shtetërore apo enteve publike, të cilat kanë në fushë të përgjegjësisë së tyre shtetërore, menaxhimin e situatave emergjente, të cilat shkaktohen nga emergjencat natyrore apo emergjencat civile.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Për zbatimin e opsionit të preferuar, ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit dhe degët vartëse të saj, të cilët marrin masat për të arritur objektivat e politikës së caktuar. Nuk parashikohen pengesa për zbatimin e opsionit të preferuar.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Për monitorimin e opsionit të preferuar, planifikojmë të mbledhim të dhënat mbi rastet e lëvrimit të mallrave të grupit A, me urdhër të Kryeministrit.

•

Të dhënat e mbledhura për monitorim do të krahasohen me të dhënat nga periudha e nivelit bazë, përpara se të propozoheshin ndryshimet për opsionin 1 të preferuar .

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			